



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.04.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti i veprimtarisë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Dritan Bici, Evis Kushi, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj, Arben Elezi

Mungojnë:

Senida Mesi, Ambra Barova

Të ftuar:

Gent Sejko- Guvernator i Bankës së Shqipërisë

Erald Themeli- Drejtor i Departamentit të Politikës Monetare

Deniz Deralla- Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes

Klodion Shehu- Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar

Marian Gjermani-Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare

Erinda Çausi- përgjegjëse e Sektorit të Komunikimit

Enri Herri- përgjegjës i Zyrës së Protokollit

Fabiola Çela- specialiste për Marrëdhëniet me Median

Ermir Maliqaj- specialist fotograf/kameraman

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi raportimin për veprimtarinë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018, paraqitur nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Të ftuar janë zoti Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, zoti Ralf Themeli, drejtor i Departamentit të Politikës Monetare, Klodian Shehu, drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar, Marjan Gjermani drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare.

Falënderoj Guvernatorin dhe stafin e tij për punën e mrekullueshme që ka bërë gjatë të gjithë periudhës së mandatit të tij, e cila reflektohet në të gjitha detajet e raportimit, dhe është vlerësuar nga komisioni edhe në draftrezolutën që ne kemi përgatitur për ta paraqitur në Kuvend.

Ndërkohë, kam një falënderim specifik për Guvernatorin, për periudhën që kemi punuar bashkë kur unë drejtoja Ministrinë e Financave, por specifikisht për vëmendjen shumë të madhe që Guvernatori dhe Banka kanë treguar gjatë dy vjetëve të fundit për uljen e kredive të këqija, për monitorimin e detajuar e të thelluar të të gjithë sektorit bankar, vëmendjen e thellë në procesin e integritetit të sektorit bankar, me procesin e deeuroizimit, që ka filluar të japë efektet e veta modeste, dhe një meritë të madhe ka Banka e Shqipërisë dhe ju personalisht Guvernator për harmonizimin e politikave financiare me ato fiskale, që ka bërë të mundur që ekonomia shqiptare të rritet me mbi 4%.

Unë mendoj të flasë në fillim relatorja, zonja Kushi dhe pastaj Guvernatori.

Evis Kushi – Faleminderit!

Në mënyrë shumë të përmbledhur do të them diçka në lidhje me vlerësimin e punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2018, për t'u ndalur pak më në hollësi në rekomandimet që Komisioni i Ekonomisë jep për Bankën e Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson pozitivisht veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2018 dhe politikat e ndjekura prej saj, në mënyrë të veçantë përmbushjen me përkushtim dhe profesionalizëm të detyrave kushtetuese dhe ligjore gjatë vitit 2018, të pasqyruara edhe nga trendi pozitiv i zhvillimeve ekonomike dhe monetare të vendit, zbatimin e një politike monetare me synime stimuluese, në funksion të përmbushjes së objektivit të saj primar, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe në funksion të krijimit të një mjedisi financiar likuid me

norma të ulta interesi dhe me luhatje të pakta në tregjet financiare; ndjekjen në vazhdimësi të problematikave të lidhura me mbiçmimin e kursit të këmbimit të monedhës vendase dhe efektet e këtij mbiçmimi në secilën prej kategorive të risqeve; përpjekjet në drejtim të zgjerimit të tregjeve financiare dhe sistemeve të pagesave, administrimin e rezervës valutore dhe monedhës kombëtare, si edhe përpunimit të statistikave, dhe së fundi, mbështetjes së procesit të integritetit evropian të vendit si dhe vijimin e procesit të përafrimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme institucionale me atë të sistemit evropian të bankave qendrore.

Kuvendi për vitin 2019 i rekomandon Bankës së Shqipërisë të zbatojë strategjinë e politikës makroprudenciale, e cila, siç referohet nga raportimi në Kuvend, synon ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe trajtimin e rrezikut sistematik në funksion të garantimit të një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe të suksesshëm; të zbatojë dhe monitorojë në vijimësi planet e miratuara të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo bankë në funksion të realizimit të mandatit të bankës që i njej ligji për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankë; të identifikojë faktorët dhe veprimet e nevojshme që duhen ndërmarrë për të bërë të mundur parashikimin e kthimit të normës së inflacionit pranë objektivit në funksion të parashikimeve të lidhura me normën e inflacionit; të identifikohet qartë objektivi në përqindje dhe të detajohet në terma kohorë parashikimi për periudhën e konsideruar afatmesme; të bëhet analiza e rritjes së portofoleve të kredisë sipas sektorëve duke detajuar rritjet sektoriale të kredisë me risqet e sektorëve për të identifikuar radhën prioritare të inspektimeve lidhur me riskun e lartë.

Nuk po ndalem shumë gjatë, sepse ka edhe pika të tjera të cilat ne do t'i paraqesim më hollësisht në rezolutën përfundimtare.

Së fundi, do të thosha që në funksion të rritjes së transparencës Banka e Shqipërisë të mos kufizohet vetëm në aktivitete që nxisin transparencën e veprimtarive të Bankës së Shqipërisë, por të përmirësojë cilësinë dhe thellësinë e analizave profesionale, që i vihen në dispozicion publikut dhe grupeve të ndryshme të interesit me qëllim orientimin e tyre drejt zgjedhjeve dhe investimeve të shëndetshme. Faleminderit!

Arben Ahmetaj- Faleminderit, zonja Kushi!

Shtesa e fundit që komisioni bëri në draftrezolutën ka të bëjë me rekomandimin që komisioni i jep Bankës së Shqipërisë për të punuar me sistemin bankar për rritjen e kredisë ndaj sektorit privat, së pari, dhe, së dyti, në aspektin e mbështetjes së ndihmës të konsumatorit të produkteve financiare t'i kërkohet sistemit bankar një transparencë shumë e detajuar, shumë e

duruar dhe shumë e thellë për t'u shpjeguar konsumatorëve dhe kredimarrësve, se çfarë, në fakt, janë duke firmosur. Së treti, për një edukim më të gjerë për kriptomonedhën, një realitet global që është detyrë e Bankës së Shqipërisë dhe e institucioneve të tjera shtetërore, por edhe e bankave për edukim të qytetarëve për kriptomonedhën.

Këto janë disa shtesa që u bënë gjatë konsultës së fundit për draftrezolutës.

Fjala për zotin Sejko.

Gent Sejko – Faleminderit!

Faleminderit për vlerësimet e punës dhe për bashkëpunimin e deritanishëm dhe në vazhdimësi!

Do të bëj një prezantim të Bankës së Shqipërisë për rezolutën e vitit 2018.

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, ju falënderojmë për ftesën!

Raporti Vjetor dhe pasqyrat financiare që e shoqërojnë atë, janë instrumentet kryesore të llogaridhënies sonë institucionale. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë e shikon prezantimin e këtij Raporti si një mundësi për të forcuar e përmirësuar dialogun me ju.

Puna e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2018 është bazuar në tri premisa kryesore: Së pari, në objektivat dhe detyrat e përcaktuara në kuadrin ligjor e nënligjor, i cili rregullon punën e institucionit; së dyti, në objektivat e përcaktuar në Strategjinë tonë Afatmesme të Zhvillimit; dhe, së treti, në rekomandimet e dhëna nga Kuvendi në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017”.

Rezultatet e punës sonë tregojnë se Banka e Shqipërisë ka shënuar progres në të tria drejtimit e mësipërme.

Më lejoni t'i shtjelloj shkurtimisht që në fillim të fjalës time.

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Banka e Shqipërisë:

kujdeset për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si parakusht për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit; licencon, mbikëqyr dhe rregullon aktivitetin e sektorit bankar, duke promovuar kështu stabilitetin financiar; administron emetimin dhe qarkullimin e monedhës shqiptare; kontribuon në zhvillimin e sistemit të pagesave; si dhe kryen një sërë detyrash të tjera specifike, të cilat prekin jetën ekonomike dhe sistemin financiar të vendit.

Bazuar në informacionin e disponuar Banka e Shqipërisë konstaton se viti 2018 ishte një vit progresi për ekonominë dhe financat shqiptare. Aktiviteti ekonomik dhe punësimi vijuan

të zgjerohen, pagat dhe presionet e brendshme inflacioniste erdhën në rritje, treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar shënuan përmirësim dhe një sërë indikatorësh të balancave të brendshme dhe të jashtme ekonomike erdhën drejt forcimit. Kjo dinamikë zhvillimesh pasqyron, në një masë jo të vogël, edhe efektin e politikave, masave dhe instrumenteve, të ndërmarra në vazhdimësi nga ne.

Më konkretisht, gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë: ka ndjekur një politikë monetare stimuluese, e cila ka nxitur rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv, si dhe ka ndihmuar përmirësimin e bilanceve të biznesit, familjeve, sektorit publik dhe institucioneve financiare të vendit; ka forcuar dhe përmirësuar kuadrin politik, rregullator e operacional, të mbikëqyrjes së sektorit bankar, duke u kujdesur njëkohësisht për administrimin e procesit të konsolidimit të tij; si edhe, ka krijuar incentiva për zhvillimin e sistemit të pagesave dhe zgjerimin e thellimin e tregut financiar.

Sa i takon përmbushjes së objektivave të strategjisë, Banka e Shqipërisë ka punuar intensivisht për përvetësimin e standardeve dhe praktikave më të mira të bankingut qendror. Në këtë drejtim, ne kemi bërë progres në përmirësimin e statistikave, punës kërkimore, plotësimit të kriterëve të integritetit të vendit në Bashkimin Europian, forcimit të qeverisjes së institucionit, si dhe në shumë drejtime të tjera.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka plotësuar të gjitha rekomandimet e lëna nga Kuvendi.

Raporti vjetor shtjellon në detaje veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2018, në të gjitha dimensionet e saj. Gjatë fjalës sime do të bëj fillimisht një përmbledhje të punës së Këshillit Mbikëqyrës, si organi vendimmarrës dhe monitorues i aktivitetit të institucionit. Më tej do të shtjelloj në mënyrë të përmbledhur aktivitetin e Bankës së Shqipërisë sipas linjave kryesore të veprimtarisë.

Aktiviteti i Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës i ushtron kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e ligjit organik dhe me procedurat e parashikuara në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e tij. Gjatë vitit 2018 Këshilli Mbikëqyrës zhvilloi 15 mbledhje dhe miratoi 76 vendime, prej të cilave 55 ishin akte të reja dhe 21 ndryshime aktesh ekzistuese. Këto vendime mbuluan gjithë spektrin e aktiviteteve të ushtruara nga institucioni. Vendime të rëndësishme, përtej miratimit të politikës monetare dhe rishikimit të rregulloreve që konturojnë aktivitetin e

sektorit bankar, janë: miratimi i politikës dhe masave për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave; miratimi i politikës së mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes; miratimi i politikave kontabël sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar; dhe miratimi i strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2019-2021.

Përtej realizimit të objektivave ligjorë të Bankës, Këshilli Mbikëqyrës ka mbajtur në monitorim qeverisjen e institucionit dhe ka punuar për përmirësimin e saj. Si përgjegjës për procesin e raportimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm, Këshilli është informuar rregullisht, nga hallkat e kontrollit të brendshëm e të jashtëm, për respektimin e ligjit dhe akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Po ashtu, Këshilli është informuar për politikat e administrimit të institucionit dhe përdorimin e mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë. Në mënyrë periodike, janë paraqitur informacione për pozicionin dhe rezultatin financiar të Bankës së Shqipërisë dhe për ecurinë e administrimit të rezervës valutore.

Monitorimi i kontrollit të brendshëm është kryer nëpërmjet Komitetit të Auditit, të krijuar në vitin 2015. Në komitet janë diskutuar çështje si: plani vjetor i punës dhe angazhimet e auditimit të brendshëm për vitin; raportimi periodik i Inspektorit të Përgjithshëm mbi veprimtarinë e auditimit; pasqyrat financiare; dhe ecuria e administrimit të rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë. Ai ka kryer takime të rregullta dhe pa praninë e administratorëve me Inspektorin e Përgjithshëm.

Së fundi, gjej me vend të theksoj se Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit dhe detyrimet e transparencës ndaj sistemit financiar dhe publikut.

Ekonomia shqiptare dhe politika monetare gjatë vitit 2018

Politika monetare ka ruajtur, e madje forcuar, kahun e saj lehtësues gjatë vitit 2018. Kjo politikë është në përputhje me përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit, konsistente me pozicionin ciklik të ekonomisë shqiptare dhe e harmonizuar me kahun konsolidues të politikës fiskale.

Ekonomia shqiptare pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2018. Kërkesa agregate erdhi në zgjerim, duke mundur rritjen e mëtejshme të prodhimit, të punësimit e të pagave, si dhe duke ndihmuar në përmirësimin e balancave kryesore ekonomike e financiare të vendit. Më lejoni të

sjell disa shifra për ilustrim. Sipas të dhënave të INSTAT-it ritmi i rritjes ekonomike u përshpejtua me 4,1% gjatë vitit 2018. Rritja ekonomike pati bazë të gjerë dhe pasqyroi kontribute pozitive nga zgjerimi i konsumit familjar, investimi i biznesit dhe i eksporteve. Po sipas të dhënave të INSTAT-it punësimi në ekonomi u rrit me 1,6% gjatë vitit të shkuar, ndërsa norma e papunësisë u ul në 12,3% krahasuar me 13,4% që ishte 1 vit më parë.

Deficiti i llogarisë koherente zbriti në 6,7% të PPB-së gjatë vitit 2018, nga niveli 7,5% që ishte një vit më parë. Përmirësimi i tij reflektoi në një masë të madhe rritjen e aktivitetit turistik. Deficiti buxhetor dhe borxhi publik vijuan të shënojnë një tendencë në rënie, duke pasqyruar si kursin konsolidues të politikës fiskale ashtu edhe rritjen ekonomike dhe forcimin e kursit të këmbimit. Treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar dhe në veçanti ai i likuiditetit të përfitueshmërisë dhe i kapitalizimit mbeten në nivele të kënaqshme. Kundrejt këtyre zhvillimeve inflacioni vjetor rezultoi mesatarisht 2%, duke mbetur në nivel të njëjtë me atë të vitit 2017 dhe poshtë objektivit tonë prej 3%.

Stabiliteti i inflacionit i detyrohet veprimit të dy efekteve me kahe të kundërta. Rritja e presioneve të brendshme inflacioniste e gjeneruar nga rritja e punësimit, pagave dhe kostove të prodhimit u neutralizua nga mbiçmimi i shpejtë i monedhës vendase në gjysmën e parë të vitit. Mbiçmimi i kursit të këmbimit ka qenë një faktor frenues për arritjen e objektivit tonë të inflacionit. Kursi i këmbimit ka ndjekur një trend të lehtë forcimi gjatë 3 vjetëve të fundit i ndikuar nga faktorë themelorë që ndikojnë në sjelljen e tij, si përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë, nivelet e larta të investimeve të huaja direkte dhe reduktimi i primeve të rrezikut në tregjet e brendshme financiare.

Megjithatë, përtej këtyre efekteve kursi i këmbimit ishte subjekt i disa goditjeve në gjysmën e parë të vitit 2018. Këto goditje sollën zhbalancimin e përkohshëm të kërkesës dhe ofertës për valutë dhe ndikuan në krijimin e pritjeve për forcimin e mëtejshëm të kursit, duke u shoqëruar edhe me ndryshimin e sjelljes së disa operatorëve të ekonomisë. Ata iniciuan një spirale të shpejtë të forcimit të kursit në 3 mujin e dytë dhe u shoqëruan me çrregullim të funksionimit të tregut të brendshëm valutë.

Në këto rrethana Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjykoi se ritmi i shpejtë i forcimit të kursit rrezikonte përmbushjen e inflacionit në afat të mesëm. Rrjedhimisht, në përputhje të plotë me objektivin e stabilitetit të çmimeve dhe pa cenuar regjimin e lirë të kursit të këmbimit, Këshilli Mbikëqyrës në muajin qershor vendosi reduktimin e normës bazë të interesit

nga niveli 1,25% në nivelin 1%, dhe paralelisht me të u reduktuan normat e interesit të depozitës dhe të kredisë 1-ditore dhe fillimi i një programi blerjeje valute, me synim frenimin e ritmit të forcimit të kursit të këmbimit dhe krijimin e premisave për një aktivitet normal tregtimi në tregun e brendshëm valutor.

Ulja e normës bazë të interesit synoi reduktimin e mëtejshëm të kostove të financimit dhe zbutjen e presioneve forcuese në kursin e këmbimit. Ndërhyrja në tregun e brendshëm valutor, si një instrument i përkohshëm dhe i jashtëzakonshëm i politikës monetare, u konsiderua i nevojshëm në kushtet kur hapësira për reduktimin e mëtejshëm të normës bazë të interesit ishin të pakta. Këto ndërhyrje në tregun valutor u përqendruan gjatë muajve të verës, më tej ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në treg kanë qenë praktikisht inekzistente dhe kursi i këmbimit ka pasqyruar raportet e kërkesës dhe të ofertës të vetë tregut.

Rezultatet e deritanishme tregojnë se ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor i kanë përmbushur objektivat. Ritmi i mbiçmimit i kursit të këmbimit është zbutur dhe aktiviteti i tregut valutor është kthyer në parametra normalë. Në përputhje me këto zhvillime Banka e Shqipërisë ruajti të pandryshuar kahun dhe intensitetin e stimulit monetar gjatë 6-mujorit të dytë të vitit. Norma bazë e interesit mbeti e pandryshuar në nivelin 1%, ndërkohë që tregu financiar u furnizua me likuiditetin e nevojshëm dhe u orientua në qëndrimin e politikës monetare për të ardhmen.

Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka rezultuar e suksesshme në nxitjen e rritjes ekonomike, shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomi. Përcjellja e stimulit monetar u vërejt në disa drejtime:

Së pari, stimulimi monetar ka sjellë uljen e kostove të financimit për familjet dhe bizneset shqiptare. Normat e interesit janë pranë minimumeve historike në të gjithë harkun e instrumenteve financiar.

Së dyti, politika monetare lehtësuese ka ndihmuar zgjerimin e kreditimit në lekë dhe uljen e kostove të shërbimit të borxhit. Kredia në lekë për sektorin privat u rrit mesatarisht me 6,7% gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2018. Paralelisht me të ulja me 5,6 pikë përqindje e normës së interesit të kredisë në lekë në raport me vitin 2011, vit, i cili korrespondon me fillimin e lehtësimit të politikës monetare i kursen biznesit dhe familjeve shqiptare rreth 15 miliardë lekë në vit.

Së treti, politika monetare lehtësuese ka mbështetur stabilitetin financiar të vendit. Rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime dhe ulja e kostos së borxhit ka sjellë përmirësimin e aftësisë paguese të bizneseve dhe familjeve, si dhe ka inkurajuar ristrukturimin e kredive. Po ashtu, orientimi i kredidhënies drejt lekut ka ulur ekspozimin e ekonomisë dhe të sistemit financiar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Masat e politikës monetare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë kanë kontribuar në zgjerimin e kërkesës agregate dhe në nxitjen e rritjes ekonomike. Vlerësimet tona sugjerojnë se politika monetare lehtësuese ka kontribuar pozitivisht, mesatarisht me 0,5 pikë përqindje në rritjen ekonomike gjatë 2 vjetëve të fundit.

Gjithashtu, kursi stimulues i politikës monetare ka kontribuar në qëndrueshmërinë e monedhës vendase. Të dyja këto kanale transmetimi kanë ndihmuar dhe do të vijojnë të ndihmojnë stabilitetin e çmimeve në vend. Trendet aktuale të zhvillimit të ekonomisë dhe parashikimet tona sugjerojnë se inflacioni do të kthehet në objektiv brenda një horizonti kohor 2-vjeçar.

Së treti, mbikëqyrja bankare dhe stabiliteti financiar.

Drejtimet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit financiar kanë qenë forcimi i qëndrueshmërisë së sistemit bankar, rritja e rezistencës së tij në përballimin e goditjeve, adoptimi i standardeve ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit, si dhe administrimi i procesit të konsolidimit në sektorin bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet është e lartë. Veprimtaria e sektorit bankar gjatë vitit 2018 u paraqit e qëndrueshme dhe me tregues të mirë të performancës dhe rezistencës financiare. Rezultati financiar i sistemit ishte pozitiv, norma e kthimit nga aktive rezultoi në nivelin 1,3%, norma e kthimit nga kapitali rezultoi në nivelin 13%. Nivelet e kapitalizmit, likuiditetit rezultuan mbi kërkesat rregullatore përkatëse të Bankës së Shqipërisë. Rreziku i kredisë vijon të përfaqësojë rrezikun kryesor të aktivitetit të sektorit bankar, por cilësia e kredisë është rritur në krahasim me 1 vit më parë. Në fund të vitit 2018, raporti i kredive me probleme shënoi vlerën 11,1% krahasuar me 13,2% që ishte 1 vit më parë, ndërkohë që teprica e kredive me probleme u zvogëlua me 20%.

Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet e saj në kuadër të planit kombëtar, për reduktimin e kredive me probleme. Në funksion të këtij qëllimi ajo ka hartua draft-rregulloren për adresimin jashtëgjyqësor të kredimarrësve, ka shtrirë kërkesat për përdorimin e pasqyrave financiare në vlerësimin e rrezikut të kredisë së huamarrësve për gjitha

kategoritë e huamarrësve (kjo është në kuadrin e luftës së informalitetit që ne kemi bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave gjatë vitit 2018), ka iniciuar masa për përmirësimin e regjistrimit të kredive dhe ka nisur punën për harmonizimin e raportimit të kredive në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në respektim të synimit për ruajtjen e stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për ndërtimin dhe zhvillimin e instrumenteve të politikës makro-kredenciale dhe për ndërtimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet sistemike. Në këtë kuadër dua të veçoj dy zhvillime kryesore.

I pari, lidhet me masat në kuadër të rritjes së përdorimit të monedhës vendase, si instrument për rritjen e efektivitetit të politikave ekonomike dhe për uljen e rreziqeve financiare.

Gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë miratoi disa ndryshime rregullative në këtë drejtim, që kanë të bëjnë me uljen e normës së rezervës së detyrueshme për depozitat në lekë dhe rritjen e asaj për depozitat në valutë, rritjen e nivelit minimal të kërkuar për raportin e aktivive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë dhe vendosjen e kërkesave për rritjen e transparencës lidhur me rreziqet për huamarrësit për kredinë në valutë.

I dyti lidhet me hartimin e bazës rregullative për krijimin e rezerva makro-kredenciale të kapitalit në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Rezervat e kapitalit zbusin rreziqet sistemike, ciklike dhe strukturore të veprimtarisë së sistemit bankar, duke synuar parandalimin e rritjes së shpejtë të kreditimit dhe huamarrjes, kufizimin e përqendrimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekspozimeve dhe kufizimin e rrezikut të tepër të institucioneve financiare sistemike.

Në drejtim të përmirësimit të proceseve mbikëqyrëse Banka e Shqipërisë ka punuar për vlerësimin e procedurave të brendshme të vlerësimit të rreziqeve, shqyrtimin e planeve individuale të bankave për rimëkëmbjen dhe vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përshtatjen e kuadrit rregullator me aktet ligjore e rregullatore të Bashkimit European dhe të dokumenteve të Bazelit.

Monitorimi i sistemit financiar është mbështetur nga inspektimet në vend. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar ekzaminime të plota dhe të pjesshme në 7 banka, në 10 subjekte financiare jo banka dhe në 31 zyra të këmbimit valutor.

Vëmendje kryesore u është dhënë ekzaminimeve të bankave, që zënë peshën kryesore në aktivitetin e tregut bankar, ose atyre në proces blerjesh ose bashkimi, si dhe bankave me ritëm të lartë rritjeje në peshën e tregut.

Në përgjithësi institucionet e monitoruara kanë reaguar në kohën e duhur ndaj rekomandimeve duke marrë masat përkatëse.

Një vëmendje të madhe ka marrë mbikëqyrja për zbatimin e masave dhe parandalimin e pastrimit të parave, e kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

Bashkëpunimi me këtë drejtori ka vijuar në mënyrë intensive edhe në kuadër të procesit të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, pra Komiteti Moneyval.

Banka e Shqipërisë mori pjesë aktive në plotësimin e komenteve në lidhje me pyetësin teknik dhe atë të efektivitetit.

Në raportin përfundimtar të Komitetit Moneyval, subjektet financiare, pra bankat dhe institucionet financiare jo banka u vlerësuan në nivelin “i konsiderueshëm” të efektivitetit, një nga nivelet më të larta të vlerësimit. Veçanërisht, bankat paraqesin një njohje të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe detyrimeve ligjore, si dhe kanë marrë përgjithësisht masat e duhura në raport të drejtë me nivelin e vlerësuar të rrezikut për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Në kuadër të konsolidimit të sektorit bankar, gjatë vitit 2018 kanë ndodhur disa ndryshime strukturore të pronësisë së sistemit bankar, të cilat e çuan numrin e bankave në sistem në 14 në fund të vitit: Banka Intesa SanPaolo mori në pronësi dhe u bashkua me Bankën Veneto, dhe Banka Amerikane e Investimeve mori pronësinë dhe u bashkua me Bankën NBG Shqipëri. Dua të nënvizoj që këto ndryshime u diktuan nga zhvillime në vendet e origjinës së bankave evropiane apo strategjitë e tyre ndërkombëtare, dhe jo nga probleme të brendshme të tregut shqiptar.

Më tej, në fillim të vitit 2019 u hap rruga për ndryshimin e pronësisë së Bankës Ndërkombëtare Tregtare dhe të Bankës Societe Generale Albania. Ndryshime ka pasur edhe në pronësinë e dy bankave të tjera, ku njëra prej tyre është reflektuar në rritjen e peshës së kapitalit vendas në treg.

Banka e Shqipërisë vlerëson se konsolidimi i sistemit bankar është një zhvillim i mirëpritur, i cili do të sjellë një gjallërim të aktivitetit bankar, do të rrisë eficiencën e industrisë bankare dhe do të mbështesë politika zhvilluese dhe inovative kreditimi e pagesash.

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka hartuar kuadrin rregullator dhe procedural për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke synuar harmonizimin me standardet ndërkombëtare, si dhe ka filluar faza e parë e hartimit të planeve individuale të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 është themeluar Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe është ngritur procedura për monitorimin e administrimit të tij duke thelluar marrëdhëniet e bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Në mbyllje, gjej me vend të theksoj edhe një herë se ruajtja e stabilitetit financiar është detyrë e përgjegjësi jo vetëm e Bankës së Shqipërisë, por edhe e agjencive të tjera rregullatore dhe e qeverisë shqiptare.

Politikat dhe masat për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe forcimin e rezistencës së sistemit bankar, kërkojnë vijimin e përpjekjeve të koordinuara, ndërinstitutionale dhe multidimensionale.

Së katërti, funksionimi i sistemeve të sigurta dhe efikase të pagesave:

Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të veçantë garantimit të sigurisë dhe efikasitetit të infrastrukturës bazë të pagesave në lekë, si nëpërmjet rolit të saj si operator i sistemit, ashtu edhe nëpërmjet rolit si mbikëqyrës e katalizator. Dy sistemet që operon Banka e Shqipërisë, ai për pagesat me vlerë të vogël dhe ai për pagesat me vlerë të madhe në lekë, kanë funksionuar pa ndërprerje, me efikasitet dhe siguri. Gjatë vitit, ajo ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullativ për mbikëqyrjen e sistemeve dhe të instrumenteve të pagesave. Ndryshimet synojnë të adoptojnë praktikën evropiane për nxitjen e inovacionit në fushën e pagesave dhe krijimin e hapësirave për iniciativat private.

Një nga arritjet kryesore në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor është finalizimi i projektligjit “Për shërbimet e pagesave” (PSD2), i cili realizon transpozimin e direktivës përkatëse të Bashkimit Europian. Miratimi dhe zbatimi i tij pritet të nxisë konkurrencën dhe inovacionin në fushën e pagesave me vlerë të vogël, të rrisë transparencën e këtyre shërbimeve dhe të ofrojë një kuadër për mbrojtjen e konsumatorit.

Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave, i cili kryesohet nga Banka e Shqipërisë dhe mbledh aktorë publikë dhe privatë me interesa në fushën e pagesave, miratoi Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri për periudhën 2018-2023.

Qëllimi i strategjisë është përmirësimi i tregut të pagesave me vlerë të vogël, nxitja e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave dhe zgjerimi i përfshirjes financiare të popullsisë.

Zbatimi i strategjisë do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator, nëpërmjet përmirësimeve infrastrukturore dhe nëpërmjet edukimit financiar.

Në mënyrë të përmbledhur do të kaloj në disa aktivitete të tjera të Bankës së Shqipërisë: në fushën e statistikave, ka vijuar puna për përafrimin metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas *acquis communautaire*. Në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me mbështetjen me ekspertizë nga Bashkimi Evropian, Banka e Shqipërisë ka koordinuar punën për zhvillimin e treguesve të disbalancave makroekonomike për Shqipërinë. Gjatë vitit 2018, EUROSTAT-i kreu një mision vlerësues të Sistemit Statistikor në Shqipëri, i cili vlerësoi se statistikave të Bankës së Shqipërisë janë në përputhje me parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane.

Në fund të vitit 2018, rezerva valutore arriti nivelin 3.4 miliardë euro, e mjaftueshme për të mbuluar 6.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe 156% të borxhit të huaj afatshkurtër.

Për të rritur fleksibilitetin e administrimit të nevojave për likuiditet në valutë, gjatë vitit u finalizua marrëveshja me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare për ngritjen e një linje krediti në valutë. Marrëveshja përbën një mekanizëm të rëndësishëm në dispozicion të Bankës së Shqipërisë për të vepruar në situata krize, ose situata emergjente.

Puna kërkimore ka vijuar të mbështesë procesin vendimmarrës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2018, në fokus të hulumtimit shkencor kanë qenë çështje që lidhen me politikën monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe bashkërendimin e këtyre objektivave.

Rezultatet e punës kërkimore janë ndarë me ekspertë vendas dhe të huaj në panele shkencore, si dhe janë publikuar materiale studimore.

Pjesë e rëndësishme e strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë është krijimi i marrëdhënieve transparente dhe jetëgjata me publikun. Banka e Shqipërisë ka shtuar

komunikimin me publikun për të ofruar opinionin e saj mbi zhvillimet ekonomike e financiare, si dhe mbi rolin mbikëqyrës të Bankës në ruajtjen e ekuilibrave makrofinanciarë. Gjithashtu, ajo ka përmbushur detyrat që burojnë nga ligji “Për të drejtën e informimit” dhe ka qenë korrekte në informimin e publikut sipas kërkesave.

Gjatë vitit u organizuan disa konferenca dhe forume kombëtare e ndërkombëtare, ku u diskutuan tema në qendër të debatit të ditës dhe me interes për stadin e zhvillimeve në vend. Veçoj këtu konferencën vjetore të organizuar në bashkëpunim me Shkollën Ekonomike dhe të Shkencave Politike të Londrës (LSE), Konferenca e Muzeut apo Workshopp-i i Kërkimeve për Europën Juglindore.

Forcimi i bashkëpunimit është konkretizuar me lidhjen e disa marrëveshjeve, ku veçoj atë me Bankën Qendrore Evropiane dhe atë me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Këto marrëveshje i hapin rrugën Bankës së Shqipërisë për pjesëmarrjen me të drejta të plota në kolegjet mbikëqyrëse të bankave të rëndësishme evropiane të pranishme në vend dhe për shkëmbimin e informacionit në lidhje me planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për grupet bankare ndërkufitare.

Edukimi financiar është një instrument i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit të përcjelljes së vendimeve të Bankës së Shqipërisë në ekonomi. Krahas botimeve edukative, gjatë vitit janë organizuar aktivitete të ndryshme që kanë targetuar kryesisht brezin e ri.

Gjithashtu, ngritja e Muzeut brenda Bankës së Shqipërisë ka lehtësuar logjistikën e ndërmarrjes së fushatave edukative.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, Banka e Shqipërisë mbetet një partner serioz në angazhimet kombëtare për aderimin në Bashkimin European. Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit european janë përfshirë në objektivat afatmesëm të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë. Ajo koordinon kapitullin IV “Lëvizja e lirë e kapitalit” dhe kapitullin XVII “Politika ekonomike dhe monetare”, dhe është kontribuuese në 6 kapituj të tjerë të *acquis*.

Banka e Shqipërisë ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Plani Kombëtar për Integritetin Evropian dhe rekomandimet e Komisionit European.

Si pjesë e këtij raportimi, dua të ndalem në një moment të rëndësishëm të garantimit të mirëqeverisjes së institucionit: sistemet e kontrollit të brendshëm. Kontrolli i brendshëm është i

pavarur nga administrimi dhe kjo pavarësi sigurohet nëpërmjet Inspektorit të Përgjithshëm, të emëruar nga Kuvendi.

Forcimi i sistemeve dhe procedurave të brendshme të kontrollit e monitorimit

Viti 2018 shënoi një konsolidim dhe maturim të funksionit të administrimit të rrezikut operacional, një funksion i ri ky në Bankën e Shqipërisë. Ai mbështetet në standardet ndërkombëtare të Administrimit të Rrezikut si dhe të praktikave më të mira të bankave qendrore. Në vlerësimin e fundit, niveli i Administrimit të Rrezikut Operacional është rritur, nga “ad-hoc” në “i menaxhuar”, duke kapërcyer nivelin “bazik” dhe duke tejkaluar objektivin e Bankës së Shqipërisë.

Këtë vit ka vijuar projekti “Për hartimin dhe implementimin e programit të menaxhimit të vijueshmërisë së veprimtarisë në Bankën e Shqipërisë”, i cili aktualisht është në fazën finale të përfundimit. Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë vazhdimësinë e proceseve kritike si dhe të rimëkëmbë veprimtarinë normale të aktivitetit të Bankës sa më shpejt të jetë e mundur, në rast të një situatë krize apo emergjence.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në përfundim të fjalës sime, dua t’ju siguroj se Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet e përkushtuar për respektimin e objektivave të saj ligjorë, si dhe për zbatimin e detyrave e angazhimeve tona institucionale.

Perspektivat e zhvillimit të vendit mbeten pozitive, por sfidat që kemi përpara nuk mungojnë. Adresimi i tyre kërkon vëmendjen dhe angazhimin e të gjithë politikëbërësve dhe agjencive rregullatore në vend.

Ekonomia, sistemi financiar dhe publiku shqiptar, si dhe partnerët tanë institucionalë të brendshëm e të jashtëm, do të vijojnë të gjejnë te Banka e Shqipërisë një aktor të besueshëm, profesional dhe transparent. Ju falënderoj për vëmendjen!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Guvernator!

E vlerësoj raportimin dhe punën që keni bërë gjatë vitit 2018, reflektuar në ato aksione dhe veprime që ju referuat, qoftë te struktura, qoftë për shkak të ngjarjeve dhe *ad-hoc*.

Dua të veçoj ndërhyrjen shumë të kujdesshme dhe shumë të matur të Bankës së Shqipërisë gjatë verës së vitit të kaluar në momentet e vlerësimit të lekut, ku një pjesë e mirë e

eksportuesve mund të dëmtoheshin, por ndërkohë mund të krijohet një precedent jo pozitiv i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në kursin e këmbimit.

Besoj se veprimet tuaja të matura krijuan një precedent, përkundrazi, në kahun pozitiv, që Banka e Shqipërisë nuk tundohet nga thirrjet populiste, por vepron në favor të stabilitetit të pavarësisë dhe të një kursi të lirë këmbimi që ka dhënë fryte dhe benefite në ekonominë shqiptare tashmë në 30 vite dhe nuk duhet të cenohet si i tillë.

Fakti që në vitin 2018 nuk u cenua rritja e eksportit, përkundrazi, arriti rekorde historike në gati 17% rritje të eksportit, tregon që veprimtaria juaj specifiku, ndër shumë institucione të tjera, me kursin e këmbimit ishte e kujdesshme, e maturuar dhe e duhur.

E dyta, menaxhimi i ankorës së interesit, ka dhënë benefite të ndjeshme në kredit-marrjen për qytetarët shqiptarë, në rritjen prej 6,7% të kredisë në lekë, që është domethënëse, që tregon se jo vetëm fondamentet ekonomike janë stabilizuar, forcuar dhe përmirësuar, por edhe besimi te leku, te monedha, që shkon paralel me besimin tek ekonomia shqiptare, është rritur.

E treta, brenda të njëjtës klauzolë është ndihmesa që menaxhimi që ju i keni bërë ankorës së interesave në lidhje me borxhin publik. Borxhi publik vitin e kaluar ka përmirësuar nivelet më të ulëta pas krizës, pra, zbriti në neto gati 64% dhe besoj se këtu Banka e Shqipërisë ka një peshë, kontribut të barabartë me përpjekjen e qeverisë për konsolidim fiskal.

Harmonizimi që ju i keni bërë si Banka e Shqipërisë politikave tuaja me ato fiskale, bën të mundur dy elemente shumë të rëndësishme. Pikë së pari, vazhdimësinë e konsolidimit, uljen e borxhit publik.

Viti 2018 është rekordi i deficitit më të ulët historik, në 1,6% minus dhe, në të njëjtën kohë, bashkë me politikat e qeverisë dhe zhvillimet ekonomike, garantuar, lehtësuat, bëtë të mundur një rritje ekonomike mbi 4%.

Unë kam një pyetje, pasi besoj se keni qenë shumë i qartë në raportin e veprimtarisë dhe në fjalën tuaj. Si i parashikoni zhvillimet ekonomike të vitit 2019 dhe në vazhdim? Brenda të njëjtës pyetje, nëse do të ishte e mundur, si e mendoni ekspozimin e Shqipërisë në vazhdimësi në tregjet ndërkombëtare, duke e lidhur edhe me eurobond-in e fundit, ku ju ishit pjesë shumë e domosdoshme e procesit? Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, kryetar!

Për sa i përket zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, parashikimi i Bankës së Shqipërisë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme është se ne do të vijojmë me një nivel rritjeje

ekonomike rreth nivelit 3,8% në mesatare për 3 vitet e ardhshme. Në këtë rritje do të ndikojë edhe niveli i eksportit të energjisë elektrike, pasi eksporti i energjisë elektrike, që pati një kontribut të konsiderueshëm në vitin 2014, që ishte një vit shumë i mirë hidrik. Viti 2018 ishte shumë mirë në drejtim të rritjes ekonomike bazuar në eksportet, investimet e huaja dhe eksportin e energjisë elektrike. Ndoshta viti 2019 nuk pritet një vit kaq i mirë hidrik, i cili të korrektojë rritjen ekonomike. Në periudhën afatmesme ne parashikojmë të kemi një rritje ekonomike rreth nivelit që thashë. Sigurisht që ka shumë faktorë të tjerë që e sfidojnë këtë rritje ekonomike, pasi jo vetëm në Shqipëri dhe në rajon, por edhe në Eurozonë, balanca e rreziqeve paraqitet në kahun e poshtëm. Ne sapo u kthëm nga mbledhjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ekonomia botërore dhe europiane po përballen me rreziqe dhe sfida shumë të mëdha. Parashikimet e bankave qendrore të të gjitha kontinenteve, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Komitetit European janë për poshtë. Janë disa parashikime që janë korriguar dhe si mbyllja e hendekut negativ të prodhimit, edhe parashikimi i arritjes së objektivit të inflacionit janë shtyrë në kohë. Megjithatë, ekonomia shqiptare ka përfituar nga shumë elemente, pavarësisht nga balanca e rreziqeve dhe sfidat, ka pasur një rritje ekonomike të mirë dhe ne parashikojmë që do të vazhdojmë trendin e rritjes ekonomike, pavarësisht se balanca e rreziqeve paraqitet në kahun e poshtëm.

Arben Ahmetaj – Çfarë do të thotë se paraqitet në kahun e poshtëm balanca e rritjes, për qytetarët dhe për komisionin?

Gent Sejko – Shumë vende të Bashkimit European, vende të Eurozonës, të cilët janë partnerët tanë tregtarë kanë probleme të mëdha në zhvillimin e tyre ekonomik, kanë probleme me sistemin financiar.

Së pari, ne e vumë re se tërheqjen e disa degëve të bankave i përballuam me sukses, pasi të gjitha ndryshimet u bënë me konsolidim të sistemit financiar dhe kreditimi në ekonomi, pavarësisht nga tërheqja dhe ndryshimi i strategjive, vazhdoi të ishte në nivelin mesatarisht 5% në rritje nga viti në vit. Aktiviteti i tyre në drejtim të investimeve të huaja direkte në vendet e jashtë zonës së Bashkimit European në shtetet jo anëtare nuk është kaq agresiv sa para periudhës së krizës dhe aktiviteti tregtar është në rënie. Të gjithë këta tregues sigurisht që do të ndikonin në ekonominë e rajonit dhe të Shqipërisë. Këto janë disa balanca rreziqesh.

Gjithashtu, edhe një element tjetër rreziku është stabiliteti politik. Në rast se situata e stabilitetit ekonomik do të vazhdojë të jetë me probleme, do të reflektohet në ekonomi, si në

nivelin e investimeve të huaja, edhe në nivelin e konsumit të brendshëm. Të dy këta tregues, si niveli i investimeve dhe konsumi, janë elemente që ndikohen edhe nga stabiliteti politik, përveç faktorëve të tjerë. Këta janë treguesit kryesorë të balancës së rreziqeve.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Guvernator!

Kush ka pyetje për Guvernatorin?

Po, zonja Kushi. Më pas zonja Gjylameti.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

E falënderoj shumë Guvernatorin për prezantimin e qartë dhe të detajuar të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2018, duke përfshirë jo vetëm rezultatet, por edhe sfidat me të cilat është përballur ky institucion!

Unë kisha përgatitur disa pyetje, por pjesa më e madhe e tyre e morën përgjigjen gjatë fjalës suaj, ndaj po ndalem vetëm në një pyetje, për të cilën ne kemi qëndrimin tonë, por do të doja të dija qëndrimin tuaj si institucion i pavarur dhe si dikush që e shikon nga larg, sepse ka lidhje me situatën politike në vend.

Po jetojmë në një situatë ku politika doli nga parlamenti duke djegur mandatet dhe ndërkohë, deputetë të rinj, po të së njëjtës opozitë, po të të njëjtave listave kanë hyrë në parlament dhe tani kemi një opozitë brenda parlamentit dhe një pjesë tjetër jashtë parlamentit, që zhvillon në mënyrë të vazhdueshme protesta dhe deklaron se nuk do të hyjë në zgjedhjet lokale të 31 qershorit. Pyetja ime është: si mendoni ju që ndikon kjo situatë politike në zhvillimet ekonomike? Sa ndikon? Më konkretisht, në cilët sektor mendoni ju që ndikon kjo situatë?

Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zonja Kushi!

Ndikimi i situatës, i stabilitetit politik në situatën makroekonomike të vendit nuk është një shkencë ekzakte për ta matur ekzaktësisht, megjithatë në analizat tona ne marrim gjithmonë një parashikim historik, duke bërë një analizë të ngjashme të periudhës së mëparshme. Është pikërisht ajo që unë thashë, se një situatë destabilizimi politik do të ndikonte negativisht në investimet e huaja dhe të brendshme, pasi investorët dhe agjentët ekonomikë kërkojnë gjithmonë siguri. Mungesa e sigurisë, e cila mund të vijë nga faktorë të ndryshëm, në rastin konkret nga mungesa e një stabiliteti dhe qetësie politike, do të ndikonte në nivelin e investimeve.

Po ashtu, edhe konsumi do të ishte i ndikuar, pasi dihet që konsumi është jashtëzakonisht sensitiv ndaj faktorëve psikologjikë. Ne kemi thënë se rritja ekonomike e Shqipërisë ka qenë me bazë të gjerë rreth këtyre viteve dhe dy nga elementet kryesore në rritjen ekonomike kanë qenë investimet e huaja direkte dhe konsumi i popullatës. Pikërisht këta dy tregues do të kishin ndikimin e tyre.

Megjithatë, praktikisht, nga pyetëtorët dhe nga vërtetimet që kemi bërë, fatmirësisht, nuk kemi një perceptim thellësisht negativ. Pyetëtori i fundit, i cili i korrespondon një periudhe pak më të hershme, sepse tani do të presim pyetëtorin e 3-mujorit të radhës, tregon që ka një perceptim pozitiv. Pra, është mbi nivelin e mesatares historike të këtyre viteve në drejtim ndjeshmërisë së agjentëve të ekonomisë, që është një tregues pozitiv. Ne po e monitorojmë situatën dhe do të shikojmë në vazhdimësi. Balancën e rreziqeve ne e shikojmë në kahun e poshtëm pikërisht për këto arsye. Situata politike është e destabilizuar edhe në shumë vende të Eurozonës dhe partnerët tanë tregtarë nuk po kalojnë momentet e tyre më të mira. Ne kemi shumë sfida, por parashikimi mbetet në nivelet që thashë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Guvernator!

Ankora kryesore për të pulsuar sa i referohen qytetarët dhe sa e ngarkon situatën situata politike, është edhe kursi i këmbimit, i cili, fatmirësisht, ka qenë stabël, megjithëse në këndvështrimin tim personal, në nivele të mbivlerësuara të lekut, por jo aq shumë për shkak të përmirësimit të fondamenteve.

A ka pyetje të tjera?

Dakord, fjalën e ka zonja Blerina, zonja Neta dhe zoti Ervin Bushati.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Sejko, jo vetëm për fjalën tuaj, por edhe për raportin ku detajohet në mënyrë shumë të hollësishme veprimtaria e Bankës së Shqipërisë dhe analiza e zhvillimeve ekonomike shqiptare!

Unë kisha një pyetje për hapësirat e politikës monetare për të vepruar duke marrë parasysh normat e interesit, të cilat janë në nivele të ulëta, 1%, por edhe faktit që është shumë larg objektivit të inflacionit.

Gjithashtu, kur e parashikon Banka e Shqipërisë që inflacioni do të arrijë targetin?

Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kjo pyetje lidhet drejtpërdrejt me objektivin dhe rolin tonë sipas ligjit. Dua të sqaroj se Banka e Shqipërisë e ka ulur normën e interesit në nivelin e saj minimal historik, pasi ky është instrumenti bazë i një banke qendrore në përpjekjet e saj për të arritur objektivin kryesor të inflacionit. Sigurisht që ka edhe masa të tjera, të cilat janë parë në periudhën postkrizë, që kanë të bëjnë me teori të ndryshme, të cilat ne nuk i kemi aplikuar në Shqipëri, pasi nuk ka qenë e nevojshme. Hapësira për ushtrimin e instrumentit të normës bazë të interesit për uljen e mëtejshme është e kufizuar, por ka ende një hapësirë të vogël nëse ne do të shikojmë që objektivi i inflacionit do të ketë vështirësi për t'u arritur. Planet e tjera alternative ose planet e kontigjencës do të shiheshin në një situatë shumë më të përkeqësuar jashtë skenarit tonë të parashikimeve bazë.

Praktikisht ne jemi shumë të ndërlidhur me partnerët tanë, ekonomia jonë është një ekonomi e hapur dhe e ndërlidhur me ekonominë e eurozonës, ku të gjitha bankat qendrore europiane, por edhe bankat qendrore të vendeve të tjera e kanë shtyrë në kohë parashikimin për arritjen e objektivit të inflacionit. Parashikimi ynë për arritjen e objektivit të inflacionit ka qenë 6-mujori i dytë i vitit 2020, por duke pasur parasysh elementet që përmenda, vështirësitë në eurozonë dhe rajon për arritjen e objektivit të inflacionit, mund të kemi një shtyrje të objektivit në vitin 2021. E rëndësishme është të arrijmë të mënjanojmë efektin e mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion. Ai ka qenë ndikimi më negativ që na ka penguar. Ky ka qenë risku kryesor. Ka një llogaritje, pra një parashikim që çdo 1% e mbiçmimit të kursit të këmbimit, ndikon me 0,4% inflacion. Vitin e kaluar kemi pasur një mbiçmim të fortë, ndaj kemi bërë ndërhyrjen e jashtëzakonshme, që të shmangim ndikimin e inflacionit. Shpresojmë të kemi një qëndrueshmëri në nivelin e kursit të këmbimit, i cili, deri tani paraqitet i qëndrueshëm dhe kjo do të bënte që edhe inflacioni do të progresonte drejt objektivit, por nuk është asnjëherë shkencë e saktë. Parashikimi i inflacionit ka shumë faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, për të cilët ne përpiqemi maksimalisht të ushtrojmë instrumentet tona. Këto janë parashikimet që kemi ne.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Guvernator!

Nëse do t'i referohem edhe një herë, Guvernatori tha thelbin në aspektin e mitigimit të efektit negativ të mbivlerësimit të lekut. Pra, në 1% ndikon 0,4%, ndaj iu referova specifikisht ndërhyrjes shumë të maturuar që bëri banka, me një balancë shumë të kujdesshme, shumë të

hollë mes ekonomisë së hapur, kursit të këmbimit të lirë dhe domosdoshmërisë për të balancuar kursin e këmbimit dhe të ngadalësohet mbivlerësimi i lekut.

Faleminderit!

Fjalën e ka Neta.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Guvernator për prezantimin dhe punën e bërë nga ana juaj dhe stafit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018, si dhe për zbatimin e detyrimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2017!

Unë kam dy pyetje.

E para, sistemi bankar po ristrukturohet. Banka e Shqipërisë, gjithashtu, ka miratuar shitjen dhe blerjen e bankave. A do të ketë ndryshime të tjera në sistemin bankar? A po e mbikëqyrni ju si bankë rreptësisht këtë proces të shitblerjes së bankave? Sa të sigurt jeni ju se pronarët e rinj të bankave nuk do të kenë kapitale ofshore?

E dyta, ka të bëjë me një temë që edhe kryetari i komisionit e preku në fjalën e tij. Ka kaluar një vit nga miratimi i paketës deorizimit, cilat janë efektet pozitive të saj? A keni menduar ta shtrini këtë paketë edhe në pjesë të tjera të tregut përveç atij bankar? Cilat janë planet ndërinstitutionale në këtë drejtim nga ana e Bankës së Shqipërisë?

Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zonja Dhima!

Për pyetjen e parë, doja t'ju sqaroja për ristrukturimin e sistemit bankar.

E kemi theksuar në këtë komision, edhe para shumë vitesh në prezantimet e para, që situata postkrizë do të sjellë shumë ndryshime në formatimin dhe përbërjen e aktorëve të sistemit financiar. Aktorët kryesorë janë bankat. Pra, do të kemi shumë bashkime me përthithje, sepse është një fenomen që ka ndodhur dhe po ndodh në të gjitha vendet e botës. Kriza ka ndikuar në aktivitetin financiar të bankave më të mëdha europiane. Si pasojë, kanë ndryshuar strategjitë e tyre kundrejt vendeve të rajonit.

Disa banka, si Societe General, Credit Agricole e të tjerë emra të mëdhenj, që operojnë në eurozonë, kanë vendosur të tërhiqen nga vendet e rajonit, si pasojë e vështirësive të tyre financiare.

Sfida jonë ka qenë të shkojmë drejt konsolidimit të sistemit bankar, që do të thotë ulje e numrit të bankave, me aq sa mund të ishte e mundur, ruajtja e cilësisë së aktivitetit bankar në vend dhe e cilësisë së aksionerëve.

Së pari, kemi arritur konsolidimin e sistemit financiar. Këtë vit, nga 16 banka do të arrijmë në 12 banka, pasi disa banka janë bashkuar me përthithje. Në 2-3 banka të tjera kemi miratuar ndryshime në sistemin bankar. Pra, drejt konsolidimit është ecur pozitivisht. Njëkohësisht, këto ndryshime kanë krijuar pesha të barabarta në treg. Pra, bashkimet me përthithje ose ndryshimet e aksionerëve kanë krijuar një numër bankash, që janë shumë të përafërta me peshën e tyre. Sigurisht, aksionerët e rinj që kanë ardhur, si dhe pesha e barabartë do të ndikonte pozitivisht në drejtim të konkurrencës dhe këto banka do të ishin më të shëndetshme në këtë aspekt. Kjo na bën të shpresojmë për rritje të aktivitetit bankar dhe të kreditimit në ekonomi.

Natyrisht, ne kemi miratuar plane specifike mbikëqyrëse, që të kemi një frekuencë më të shtuar dhe një vëmendje më të madhe nëpërmjet inspektimeve nga jashtë dhe në vend. Të gjitha këto banka, që kanë pësuar ndryshime, do të mbikëqyren shumë intensivisht. Kemi programe intensive për këto banka, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, në mënyrë që të jemi të sigurt për ecurinë e tyre. Gjithsesi, treguesit e sistemit bankar, mjaftueshmëria kapitale dhe e likuiditetit në të gjitha bankat, si tek ato që kanë pasur ndryshime aksionerësh, edhe tek ato që nuk kanë pasur, paraqiten më lart se nivelet minimale rregullatore. Niveli minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit është 12%. Sot jemi mbi 18%.

Bankat janë plot me likuiditet, kanë tepërisë likuiditeti. Këtë ne duam ta përkthejmë në kredi për ekonominë. Kjo duhet bërë në mënyrë të kujdesshme, që të mos shkaktojmë kredi të këqija, pra të kemi kredi të shëndetshme, që të ruajmë sistemin bankar, por edhe të ndikojmë pozitivisht në ekonomi.

Për pyetjen për aksionerët nga vendet *offshore*, Banka e Shqipërisë, në të gjitha rastet e ndryshimit të aksionerëve, ka zbatuar në mënyrë strikte kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe ka bërë investigime të thella.

Në Shqipëri nuk kemi asnjë ndalesë ligjore për vendet e origjinës, pra çdo lloj investitori, nga çdo vend i origjinës, është i lirë të investojë në sistemin bankar, por sigurisht, duke respektuar në mënyrë strikte kërkesat ligjore dhe rregullatore në Republikën e Shqipërisë.

Në të gjitha rastet ne e kemi vërtetuar këtë. Pra, nuk është e ndaluar të operosh në një vend *offshore*, por duhet të raportosh deri në përfituesin e fundit.

Banka e Shqipërisë, si autoritet licencues dhe mbikëqyrës, duhet të filtrojë dhe të shqyrtojë gjithë burimin e origjinës. Ne këtë e kemi bërë, qoftë për aksionerët, qoftë për kapitalet, që të jemi të sigurt për cilësinë dhe reputacionin e aksionerëve dhe të jetë një biznesplan i shëndetshëm, për një ecuri pozitive të sistemit bankar në të ardhmen. Pra, ky nuk është një problem. Aktualisht, ne i kemi shqyrtuar dhe filtruar sipas kërkesave të ligjit, madje kemi bërë edhe hapa të mëtejshëm për të qenë të sigurt.

Për pyetjen për deeurozimin, sikurse e përmenda edhe gjatë fjalës sime, vitin e kaluar ne kemi bërë një marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Financave. Kryetari i nderuar i komisionit ka qenë ministër i Financave në atë kohë. Ne kemi arritur një marrëveshje për të bërë një plan masash për deeurozimin e ekonomisë. Banka e Shqipërisë, veçanërisht, sepse unë përgjigjem për institucionin që drejtoj, si dhe Ministria e Financave, kanë dy qëllime kryesore.

Niveli i lartë i deeurozimit kufizon transmetimin e politikës monetare në ekonomi. Ne duam të kemi një transmetim sa më të plotë të politikës monetare në ekonomi, pasi politikat monetare lehtësuese bëhen me një qëllim, për t'u kuptuar më thjeshtë, për të stimuluar investimet, kreditimet dhe konsumin. Këto tri drejtime ndikojnë në rritjen ekonomike, prandaj ne duam të kemi një transmetim sa më të plotë të politikës monetare, nëpërmjet instrumenteve tona, për të pasur rritje ekonomike dhe mirëqenie të qytetarëve shqiptarë. Niveli i lartë i deeurozimit na e kufizon këtë instrument.

Nga ana e stabilitetit financiar, problemi është një ekspozim shumë i lartë i kredive në valutë. Për ata klientë, që i kanë të ardhurat në monedhë kombëtare, në lekë, përbën një risk potencial në të ardhmen. Në rast se ne do të kemi nënçmim të monedhës kombëtare, kjo do të silltë pamundësinë e shlyerjes së detyrimeve ndaj bankave. Situata të ngjashme ne kemi parë në shumë shtete të tjera, si Hungaria, Kroacia...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe do të kishim një krizë në sistemin bankar. Ne nuk mund ta neglizhojmë... Kursi i këmbimit është sipas një regjimi të lirë. Ne mund të kemi nënçmim dhe mbiçmim. Në rast se do të kishim nënçmim, atëherë do të përballeshim me një situatë shumë të vështirë financiare në sistemin financiar.

Këto janë arsyet që Bashkimi European, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të gjithë aktorët ndërkombëtarë, që kanë pasur histori të ngjashme, na kanë rekomanduar të ndërmarrim një politikë deeurozimi. Natyrisht, kjo politikë nuk ka të bëjë fare me kursin e këmbimit. Sigurisht, faktori psikologjik ndikon. Është keqkuptuar vitin e kaluar. Ne jemi përpjekur ta shpjegojmë këtë. Shpeshherë, ankesa shumë e madhe ndaj kategorive të caktuara, që preken... Në rastin konkret, humbasin eksportuesit dhe fitojnë importuesit dhe anasjelltas.

Banka e Shqipërisë ka si qëllim të ulë masën, por jo ta dobësojë, pasi dobësimi i kursit të këmbimit, mbiçmimi i lekut dhe nënçmimi i euros, ndikon negativisht edhe në objektivin tonë të inflacionit.

Sigurisht, leku i mbiçmuar do të ishte mirë, sepse do të tregonte që vjen nga faktorët fundamentalë, por, nga ana tjetër, ka edhe efektet e tij. Sigurisht, ne jemi në këtë situatë. Kjo është e komplikuar për ta shpjeguar deri në detaje, por unë do të thosha se i ne kemi marrë masat e duhura. Kemi biseduar me Ministrinë e Financave edhe në mbledhjen e fundit të grupit këshillimor të stabilitetit financiar, që edhe qeveria shqiptare të vazhdojë masat parandaluese, pasi, siç e dimë, kemi shumë shitblerje të mallrave në tregun shqiptar të makinave, apartamenteve, por edhe të mallrave të konsumit të përditshëm, të cilat kuotohen në monedhë të huaj në mënyrë të panevojshme. Kjo nuk e cenon aspak konsumatorin shqiptar, për sa kohë që monedha kombëtare është leku. Ne e shohim edhe në vendet fqinje, ku përdoret monedha e vendit.

Në këtë kuadër, do të vazhdojmë me masat tona për deeurozimin. Duhet të jemi shumë të qartë. Partnerët tanë tregtarë janë në eurozonë dhe nuk po diskutojmë të heqim euron nga qarkullimi dhe ta çojmë në zero. Euro do të vazhdojë të jetë një monedhë që përdoret, por duhet të përdoret aty ku duhet, aq sa duhet, që të shmanget ndikimi negativ në aspektet që përmenda.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati e ka fjalën. Më pas zoti Xhevit do të bëjë pyetjen e fundit. Patjetër, edhe Vullneti.

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Dua të përshëndes punë e pavarur të Bankës së Shqipërisë! Në kohët e sotme duket sikur pavarësia është dhuratë, por po shikojmë që edhe në vende shumë më të zhvilluara, bankat qendrore cenohen nga ndikimi i grupeve të interesit, të politikës.

Është për t'u përshëndetur qëndrimi i Bankës së Shqipërisë vitin e kaluar për ndikimin e grupeve të interesit, të politikës, që kaloi deri në histeri. Pse jo, duhet ta themi, shpeshherë edhe të medias, që bën analiza në kërkim të lajmit, që ndikojnë në dëmtimin e procesit dhe mund të lëndojnë ekonominë. Kjo ishte për t'ju inkurajuar të vazhdoni, në sensin që Banka e Shqipërisë duhet të qëndrojë fort në pavarësinë e saj.

Kisha një pyetje, që ka të bëjë me inflacionin. Ne po e shohim se normat sot në treg janë negative. Duke marrë parasysh që inflacioni është 2% dhe norma e interesit është 1%, i bie që të mbash sot para të dëmton. Po shihet që kjo prirje nuk po ndikon në rritjen e çmimeve apo të kredive. Mendoj se kemi arritur te pjesa ku janë hapur kanalet e komunikimit dhe ndryshimet strukturore. Ndoshta kjo mund të lidhet direkt me papunësinë.

Ne e dimë që në shifra akademike papunësia është e lartë, por ndërkohë po shikojmë që, sektorë të caktuar apo kur kërkohen profesionistë të niveleve specifike, ka një shtrëngim, që tregon se ndoshta në të ardhmen papunësia...

Arben Ahmetaj –Ervin, bëj pyetjen!

Ervin Bushati – ...mund të bjerë dhe çmimet në treg mund të ngrihen.

E keni në vëzhgim këtë?

Si e shikoni ju lidhjen e papunësinë me ndikimin në inflacion? Se mund të ndodhë në të ardhmen.

Kam edhe një pyetje, që, në fakt, u referua dhe nuk dua t'ju shtrëngoij për të na dhënë një shifër financiare apo ekonomike, por destabiliteti politik ndikon në ekonomi. Bllokimi i ekonomisë më të madhe në vend, siç është Tirana, në mënyrë periodike, çdo javë, në shumë vende të tjera ka nxjerrë edhe një kosto reale. Për shembull, në Francë u pa se 15-20% e ekonomisë binte nga protestat, që mbaheshin çdo të shtunë.

E di që ju nuk mund të bëni një studim të mirëfilltë për këtë, ama, mund të jepen disa parametra dhe të thuhet se sa ndikojnë këto në ekonominë më të madhe në vend, që është Tirana. Përveç klimës së pasigurisë apo efektit ekonomik, edhe financiarisht mund të ketë një shifër. Kemi dëgjuar biznesin të thotë që ditëve të shtuna që organizohen protesta ju bie xhiroja ditore me 17% apo 20%. Pra, në këtë moment duhet që Banka e Shqipërisë të ketë disa shifra reale.

Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zoti Bushati!

Po e filloj nga pyetja e dytë.

Ne jemi duke e analizuar ndikimin situatës politike, por akoma nuk i kemi nxjerrë rezultatet e punës sonë kërkimore. Departamenti i Kërkimeve është duke punuar me Departamentin e Politikës Monetare për të parë sa është ndikimi në ekonomi si pasojë e destabilitetit politik, në mënyrë që ne ta analizojmë dhe të bëjmë parashikimet e treguesve në të ardhmen. Kjo është më e vështirë për t'u matur sesa parashikimi i faktorëve të tjerë, por jemi duke punuar për të bërë një analizë të plotë dhe për të pasur ndikimin që mund të ketë ky faktor rreziku. Akoma nuk kemi të dhëna, pasi ato duan kohën e tyre për t'u matur dhe analizuar.

Për sa i përket inflacionit dhe papunësisë, patjetër që ka një lidhje korelative dhe ky faktor ndikon në inflacion. Niveli i papunësisë ka rënë. Sigurisht, ne do të donim që të binte më tej niveli i papunësisë dhe të rritej punësimi, por kjo lidhet me shumë faktorë të tjerë afatgjatë, që kanë të bëjnë me reformat strukture. Përveç reformave të tjera që do të ndikonin në investimet e huaja dhe me punësimin, një reformë e thellë afatgjatë do të ishte reforma në edukim. Sa më shumë arsimim profesional të ketë aq më shumë do të ulet papunësia. Ky është një faktor afatmesëm dhe afatgjatë që do të ndikonte në nivelin e inflacionit. Inflacioni është tregues shumë kompleks dhe aty ndikojnë të gjithë faktorët. Me kalimin e kohës ne shikojmë që presionet e brendshme dhe të jashtme inflacioniste janë rritur. Banka e Shqipërisë do të përpiqet maksimalisht që me reformat e veta strukture, brenda kuadrit ligjor, të marrë reformat e duhura në aspektin e sektorit financiar, ndërkohë që në bashkëpunim me qeverinë shqiptare do të vazhdojë ritmi i reformave.

Vetëm nëpërmjet ndërmarrjes dhe vazhdimit të reformave strukture ne do të arrijmë të zbusim ndikimin negativ të faktorëve të riskut, qoftë për të arritur objektivin e inflacionit, të rritjes ekonomike dhe të gjithë objektivat e tjera, qoftë edhe për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe financiar të vendit.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Guvernator!

Po, zoti Xhevit. Më pas e ka fjalën Vullneti.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit zoti Sejko për ekspozenë që i bëtë veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, si një kolonë shumë e rëndësishme e shtetit shqiptar. Këta faktorë kanë bërë që rritja ekonomike e vendit tonë të shkojë nga 0,5% që ka qenë në vitin 2013, në 4,3% që është sot. Detyrimisht kanë ndikuar edhe konvergjenca e këtyre faktorëve dhe të këtyre institucioneve të pavarura në realizimin konstant të kësaj rritjeje ekonomike.

Nuk e di sa ka qenë shifra e kredive të këqija në vitin 2013, por dua të di, a keni ju ndonjë parashikim që kur do të arrijnë në shifrën 7% kreditë me probleme? Së dyti, shifra e kredive me probleme, 13% në fillim të vitit 2018 dhe 11% në fund të vitit 2018, ka ardhur si pasojë e rritjes së kredive, rikonstruksionit të kredive të këqija apo daljes nga gjendja e vështirë ekonomike që mund të kenë qenë bizneset që kanë marrë kredi të tilla? Faleminderit!

Gent Sejko – Faleminderit, zoti Bushaj!

Të gjithë faktorët që ju përmendët kanë ndikuar në uljen e nivelit të kredive të këqija. Niveli i kredive të këqija ka arritur nivelin maksimal të tij në 25% të të gjithë portofolit të kredive në vitin 2014.

Në atë moment ne kemi bërë një plan masash të detajuar me qeverinë shqiptare, Ministrinë e Financave dhe institucione të tjera të linjës. Fatmirësisht, ky plan ka pasur efektet e tij pozitive duke sjellë uljen e nivelit të kredive me probleme nga 25% në 11,1% në fund të vitit të kaluar. Ne synojmë ta ulim edhe më shumë këtë përqindje. Duhet kuptuar që ky tregues është raport midis kredive me probleme dhe tepricës së kredive. Sa më shumë të rritet teprica e kredive, aq më shumë ky raport bie. Nga ana tjetër, sa më shumë të ulët niveli ... Pra, duhen prekur të dy treguesit. Ne synojmë të ulim kreditë me probleme, ta korrigjojmë situatën problematike dhe nga ana tjetër, të ndikojmë në rritjen e kreditimit të ekonomisë. Duke ecur paralelisht edhe niveli i kredive të këqija do të bjerë, edhe kreditimi do të rritet. Aktualisht bankat i kanë të mbuluara këto humbje. Duhet të jemi të qartë që rreth 70% e kredive të këqija janë të mbuluara me kolateral. Pra, niveli real i kredive të këqija po të ishte i pambuluar me kolateral, do të ishte 4,5%. Ne për të qenë më prudentë dhe më seriozë, e japim totalin pavarësisht nga vlera e mbulimit me kolateral. Shumë shtete i raportojnë kreditë e këqija të pambuluara me kolateral. Pra, niveli do të ishte 4,5%.

Megjithatë, e rëndësishme është që ne të ulim nivelin e kredive me probleme, të synojmë rritjen e kreditimit në ekonomi për të pasur një rritje sa më të shëndetshme të ekonomisë dhe të vazhdojmë zbatimin e planit të masave, i cili është në vijimësi për uljen e kredive me probleme. Kjo ulje ka ardhur si nga fshirjet e kredive të humbura, nga ristrukturimi i kredive dhe nga shlyerjet. Është vënë re në vitet e fundit që shlyerjet, rikuperimi i kredive të këqija nga vetë bizneset ka ardhur në rritje në raport, edhe me ristrukturimet, edhe me shlyerjet. Kjo është një shenjë e mirë edhe për bizneset, edhe për sistemin financiar. Le të shpresojmë që do të vijojmë ta rregullojmë. Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Vullnet Sinaj - Faleminderit, kryetar!

Unë kam një pyetje për kostot e transfertave në valutë nga banka në bankë në Shqipëri, në euro apo në valuta të ndryshme. Mendoj se këto janë kosto të larta, ndonjëherë gati të barabarta me transfertat nga Shqipëria jashtë saj. Nga një informacion që kam, por ta krahasojmë këtë kosto me kostot e bankave të vendeve të rajonit, në Serbi, apo në Maqedoni, kostot për qytetarët në Shqipëri janë më të larta.

A keni ndër mend të merrni masa si rregullator për ndërmjetësimin e bankave të nivelit të dytë për transfertat e valutës, për t'i ulur këto kosto? Njëkohësisht, mendoj se këto të ardhura do të mbeteshin në vend dhe nuk do të iknin në bankat jashtë vendit. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Vullnet!

Fjalën e ka zoti guvernator!

Gent Sejko - Faleminderit!

Kostot e transfertave në sistem janë kosto, që i përcakton tregu. Nuk më rezulton të jenë më të larta se vendet e rajonit, por pavarësisht kësaj, ky është një shqetësim dhe është detyra jonë të punojmë për rritjen e transparencës, për mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe për uljen e kostove.

Unë do të thosha se pikërisht për këtë arsye BSH-ja ka marrë vendim që brenda këtij viti të implementojë sistemin e kleringut, të qarkullimit të pagesave në euro në BSH, pasi kjo e fundit është institucioni përgjegjës për monedhën kombëtare dhe bën kleringun e pagesave vetëm për monedhën vendase (lekun). Pikërisht, për të ndihmuar biznesin shqiptar për të ulur kostot e transfertave jo vetëm për bizneset, por edhe për individët, BSH-ja ka vendosur që sistemin e saj, dy sistemet e kleringut të pagesave në lekë, t'i përdorë edhe për kleringun e pagesave në euro, që do të thotë se nuk do të përdoren më për kleringun e pagesave në euro te bankat korresponente, por do të jetë BSH-ja si institucion.

Ky projekt do të mbyllet brenda këtij viti dhe do të ketë një efekt shumë pozitiv, si në uljen e kostos së transfertave, ashtu edhe në kohën e procesimit të transfertave. Kjo është bërë pikërisht për këtë qëllim, pasi kleringu për euron bëhet me bankat korresponente. Sigurisht, ky është aktivitet i kleringut, që do të kryhet në sistem dhe jo në *cash*. Duhet të jemi të qartë që BSH-ja nuk do të bëjë kleringun e *cash*-it. Përsëri tepricat *cash* do të vazhdojnë të lëvizin nga jashtë brenda dhe nga brenda jashtë, por koha e transfertave nga jashtë brenda dhe nga brenda

jashtë, por koha e transfertave dhe çmimi i tyre pritet të bjerë ndjeshëm, pasi të implementojmë këtë sistem edhe për euron, jo vetëm për lekun. Është një përjashtim, që nuk e bëjnë bankat qendrore. E kemi bërë pikërisht për këtë qëllim.

Gjithashtu, elementi i dytë është ligji i ri për shërbimin e pagesave me vlerë të vogël, që ne e kemi përfunduar dhe e kemi dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe së shpejti do të vijë në parlament, pasi kjo është procedura e ligjit.

Sigurisht, ky ligj është bërë për të ulur shumë elementë të tjerë, për të nxitur iniciativat publike dhe private në fushën e pagesave, për të rritur transparencën, por edhe për të ulur kostot e transfertave. Këto janë ato hapësira ligjore dhe mundësi që banka qendrore ka për të kryer në këtë drejtim. Edhe ne pikërisht këtë po bëjmë. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe seanca e dëgjësive dhe e pyetjeve.

Draftrezolutën e lexoi zonja Kushi me shumë vëmendje. Në draftrezolutë do të reflektojmë edhe disa nga këndvështrimet që deputetët iu referuan nëpërmjet pyetjeve dhe referencat tuaja, guvernator, si dhe shqetësimet apo rekomandimet, që ka komisioni në emër të parlamentit. Këtu po e mbyll dëgjësën.

Ju falënderoj juve, zoti guvernator dhe stafin tuaj!

Ju uroj suksese edhe në këtë vit!

Gent Sejko – Shumë faleminderit, kryetar!

Shumë faleminderit zonjave dhe zotërinjve deputetë, për debatin konstruktiv!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti